1. Master's degree in the field of health management, economics, management and business administration, or in an area related to the scope of this ToR;
2. Minimum three (3) years of working experience in activities related to planning public investment in health;
3. Minimum ten (10) years of relevant professional work experience.
4. Experience in similar projects in the Western Europe, Central or Eastern Europe and the Western Balkans countries is considered an advantage.
5. Excellent communication skills and knowledge of English are a must
6. Submitted references on the successfully implemented projects similar to this ToR.

Hospital Planning/Civil Engineer Expertise

1. Master's degree in civil engineering, health management, economics, management and business administration or in an area related to the scope of this ToR;
2. Minimum three (3) years of work experience in activities related to planning and equipping the facility of a health care institutions;
3. Minimum ten (10) years of relevant professional experience;
4. Experience in similar projects in the Western Europe, Central or Eastern Europe and the Western Balkans countries is considered an advantage;
5. Excellent communication skills and knowledge of English are a must;
6. Submitted references on the successfully implemented projects similar to this ToR.

Human resources planning in healthcare:

1. Master's degree in the field of health management, economics, management and business administration or in the field that is related to the scope of this ToR;

2. Minimum five (5) years of work experience in the field of human resources management;

3. Minimum three (3) years of work experience in health restructuring activities;

4. Minimum ten (10) years of relevant work experience;

5. Experience in similar projects in the Western Europe, Central or Eastern Europe and the Western Balkans countries is considered an advantage;

6. Excellent communication skills and knowledge of English are a must;

7. Submitted references on the successfully implemented projects similar to this ToR.

Management of health care institutions

1. Master's degree in the field of health management, economics, management and business administration or in the field that is related to the scope of this ToR

2. Minimum three (3) years of work experience in activities related to the management of health care institutions

3. Minimum ten (10) years of relevant professional work experience;

4. Experience in similar projects in the Western Europe, Central or Eastern Europe and the Western Balkans countries is considered an advantage

5. Excellent communication skills and knowledge of English are a must

6. Submitted references on the successfully implemented projects similar to this ToR.

GIS specialist

1. University degree in Geography, Cartography and Geographic Information Systems (GIS) or another relevant degree at least at Master's level.

2. Minimum three (3) years of experience in health sector reform or in assignments of similar size and scope;

3. Minimum five (5) years of relevant professional work experience,

4. Experience in similar projects in the Western Europe, Central or Eastern Europe and the Western Balkans countries is considered an advantage.

5. Well-developed verbal and written communication skills and text processing skills as well as organization and presentation skills;

6. Good command of the English language in verbal and written communication, with the ability to present one's results in a clear and succinct manner.

7. Ability to work in a team and experience from similar projects is an advantage; Submitted references on the successfully implemented projects similar to this ToR

Development of communications strategy and plan for the public sector reforms

1. Master's degree in the field of communications or a field related to this ToR

2. Minimum three (3) years of work experience in communication activities for public sector reforms, primarily in the health sector;

3. Minimum ten (10) years of relevant professional work experience;

4. Experience in similar projects in the Western Europe, Central or Eastern Europe and the Western Balkans countries is considered an advantage

5. Excellent communication skills and knowledge of English are a must

6. Submitted references on the successfully implemented projects similar to this ToR.

Local expertise

Knowledge of the Albanian Hospital system (structure, organization, legislation, standards, history, etc.) and health information sources and stakeholders are important in each of the fields of expertise mentioned above. The consulting company should include the necessary local expertise, at least one expert for each of the identified professional areas, in its consulting proposal. The consulting team of local experts will be evaluated in the same way as the international team. The consulting company will initially propose a list of qualified local experts for the identified areas of expertise and submit their CVs for consideration by the client.

The short listing criteria are:

No.	Evaluation Criterion	Points
1.	Overall experience of the firm (number of years) in the field of assignment	30 points
2.	Number of assignment-related contracts completed during last three years	30 points
3.	General experience and qualification of the key personal	40 points
	TOTAL	**100 points**

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers (January 2011, revised July 2014), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest. The consultant should be an International Consultant. The selection method to be applied is Quality and Cost Base Selection (CQBS) in accordance with the procedures set out the World Bank's Guidelines Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers" (January 2011, revised July 2014).

The assignment will be performed under a lump sum contract that will include items such as travel/air tickets, in-out airports, local transport, interpretation, per diem, and consulting fees. Contract duration is estimated to be 9 months. The estimated level input from international consultants is 385 man/day and for local consultants 170 man/days. The consultant will conduct 4 missions in Albania which will be scheduled in collaboration with the contract management team. The prospective consultant will consider registration of its entity in the Albanian Tax Department for the purpose of payment, in case of contract signature. The contract is subject of VAT taxation and the cost will include all consultant's business taxes, insurances and liabilities.

The international consultants will work closely with the local consultants, Component Coordinator, The technical working groups and Project Coordination Unit. During the assignment, the consultants are expected to travel to Tirana to meet with Government representatives at the Ministry of Health, regions, and districts, directors of health facilities, donors and World Bank staff.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday. Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by e-mail) by **30th of November 2018 local time 16:00.**

Ministry of Health and social protection / Project Coordination Unit (PCU)

Health System Improvement Project (HSIP) Tirana, Albania
Att: Blerina Dudushi, e-mail: hsip.dudushi@gmail.com
Rruga "Aleksandër Moisiu", kati 2, Tirana, ALBANIA

NJOFTIM
Nr. 3362, datë 14.11.2018

SHPALLJE PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOHSHME" TË KRIJUAR PËR VENDIN GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 93, 125, 127, pikat 1/ç, 2, 3, dhe të nenit 179, pika 2, të Kushtetutës; të neneve 7, pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh, pika 2, 86, pika 4, shkronja "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 9, datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, njoftuar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 380/4 prot., datë 29.10.2018, me cilësinë e organit të emërtesës, me qëllim plotësimin e "Vakancës së parakohshme", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësinë e organit të emërtesës me dekretin nr. 10946, datë 9.11.2018, ka miratuar;

- Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e "Vakancës së parakohshme", të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtares znj. Altina Xhoxhaj, sipas vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe në nenin 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të marrë pjesë në këtë

procedurë të konkurrimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës:

- Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/*email);*
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërteton përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe të nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës;
- Formularin e aplikimit të plotësuar, "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të Institucionit të Presidentit të Republikës;
- Listë të dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjeni të botuar përmbajtjen e nenit 125, pika 4 e 5, të Kushtetutës dhe të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese;

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

- Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) Të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, diplomë e nivelit të dytë;

c) Të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) Të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) Të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) Të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe të verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) Të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) Të ketë një veprimtari të njohur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) Të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kritereve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

a) Vjetërsisë në profesion;

b) Përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë;

c) Kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;

ç) Treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;

d) Ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;

dh) Informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.

Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohet me postë ose drejtpërsëdrejti në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm është brenda datës 26 nëntor 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik dhe, menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës do të bëjë transparent çdo rezultat të këtij procesi, në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr. 8577/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:

Numri i telefonit: 042389898

NJOFTIM
Nr. 1164, datë 15.11.2018

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE, NË ADMINISTRIM: TË MINISTRISË SË BRENDSHME, TË DREJTORISË SË SHËRBIMIT PYJOR DIBËR, TË BASHKISË KOLONJË, TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Brendshme

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m²)	Sipërfaqja nën objekt (m²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Posta Kufitare	Trebisht, Dibër	4 309 814	3 945 494	364 320	3312	370	12.12.2018	10:00	DDPP

2. Në administrim të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Dibër

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m²)	Sipërfaqja nën objekt (m²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	5 objekte: Ndërtesë e degës teknike; magazinë qendër; kapanonet e makinave; kapanonet e makinave (Tojota); kapanon rrëshire (magazinë)	Dibër	21 765 090	19 219 738	2 545 352	746	746	12.12.2018	11:00	DDPP

3. Në administrim të Bashkisë Kolonjë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m²)	Sipërfaqja nën objekt (m²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ish-Shkolla 8-Vjeçare Rehovë	Kolonjë	5 304 906	5 028 138	276 768	2 976	231	12.12.2018	12:00	DDPP

4. Në administrim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m²)	Sipërfaqja nën objekt (m²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Magazinë ambalazhi	Bajram Curri, Tropojë	878 192	638 448	239 744	128	128	12.12.2018	13:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. Dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. Deklaratë noteriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al

NJOFTIM
Nr. 1164, datë 15.11.2018

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË BRENDSHME

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", kapitulli III, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Brendshme

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipër-faqja e përgjith-shme (m²)	Sipër-faqja nën objekt (m²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Objekte të Postës së Policisë Kufitare	Peshkëpi, Pogradec	8 433 408	7 905 408	528 000	2400	371.72	12.12.2018	14:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit tëe shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. Dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. Deklaratë noteriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar, që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al

NJOFTIM
Nr. 1164, datë 15.11.2018

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË, TIRANË

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Kofi	20.11.2009	Tiranë	4,000	11.12.2018	09:00	DDPP
2	Qeni Joga	29.5.2009	Tiranë	4,000	11.12.2018	09:30	DDPP
3	Qeni Doli	23.9.2016	Tiranë	7,500	11.12.2018	10:00	DDPP
4	Qeni Roko	7.5.2017	Tiranë	7,500	11.12.2018	10:30	DDPP
5	Qeni Bobi	1.11.2009	Tiranë	4,000	11.12.2018	11:00	DDPP
6	Qeni Bredhi	2.11.2009	Tiranë	4,000	11.12.2018	11:30	DDPP
7	Qeni Iza	7.12.2009	Tiranë	4,000	11.12.2018	12:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.

2. Garancinë bankare apo mandatpagesën në origjinal që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia

bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financa.gov.al

KËRKESË
Nr. 6567, datë 15.11.2018

PËR SHPREHJE INTERESI, PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS "PËRDITËSIMI I MODULEVE TË TRAJNIMIT DHE TRAJNIMI I ADMINISTRATORËVE SOCIALË, MBI ZBATIMIN E SKEMËS E RE TË NE-së *(FORMULA E UNIFIKUAR E PIKËZUAR)",* PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ref: SAMP/CS/CQ/03-2018

Tiranë, më 14.11.2018

Shqipëri
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)
Kredia nr. 8141-AL
Numri i identifikimit të projektit, ID nr. P122233

Republika e Shqipërisë, ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar ta përdorë një pjesë të saj për shërbime konsulence. Shërbimi i konsulencës (shërbim) së kërkuar është: **"Përditësimi i moduleve të trajnimit dhe trajnimi i administratorëve socialë mbi zbatimin e skemës e re të NE-së *(formula e unifikuar e pikëzuar)".***

Nëpërmjet këtij shërbimi, MSHMS-ja kërkon pajtimin e një firme lokale, që do të ndihmojë e do të mbështesë MSHMS-në (DPZHSHMS-në) që të përditësojë modulet e trajnimit dhe të trajnojë administratorët socialë lidhur me zbatimin e skemës e re në programin e Ndihmës Ekonomike (NE) sipas formulës së unifikuar të pikëzuar. Shërbimi i konsulencës do të zhvillohet në tri faza, duke përfshirë dhe një fazë përgatitore:

Faza përgatitore: Përditësimi i moduleve të trajnimit bazuar në ndryshimet e fundit të bëra në kuadrin ligjor, në lidhje me zbatimin e fazës pilot të reformës në programin e NE-së.

Faza e parë: Ofrimi i trajnimit për rreth 549 administratorë socialë në të gjitha rajonet dhe për rreth 106 punonjës të sistemit të shërbimeve sociale në nivel lokal dhe qendror, të cilët marrin pjesë në trajnimin e zhvilluar në fazën e parë, kalojnë të gjitha modulet dhe përdorin formulën e unifikuar të pikëzuar për programin e NE-së.

Faza e dytë: Vlerësimi dhe certifikimi i 549 administratorëve socialë dhe 106 punonjësve të sistemit të shërbimeve sociale në nivel lokal dhe qendror, të cilët marrin pjesë në trajnimin e zhvilluar në fazën e parë dhe kalojnë të gjitha modulet.

Konsulenti do të përgatisë dhe do të administrojë një testim të standardizuar për administratorët e trajnuar nën mbikëqyrjen e MSHMS-së. MSHMS-ja do të shqyrtojë dhe do të miratojë testin para se konsulenti ta zhvillojë atë. Kriteret dhe kërkesat minimale për kalimin e testit do të vendosen nga MSHMS-ja.

Firma konsulente duhet të ketë përvojë minimale 5-vjeçare në hartimin dhe në zhvillimin e moduleve të trajnimit në sektorin social. Përvoja në trajnimin e nëpunësve civilë do të konsiderohet si një avantazh. Firma duhet të ketë një ekip shumëdisiplinor, me përvojë dhe njohuri të konsiderueshme në fushën e mbrojtjes sociale, veçanërisht me programin e NE-së dhe të zhvillimit procedural, institucional dhe shoqëror në përgjithësi.

Shërbimi duhet të kryhet për 30 ditë. Kompania konsulente pritet të fillojë punën në nëntor 2018 dhe ta përfundojë atë në dhjetor 2018.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet, Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP), fton të gjitha kompanitë lokale të konsulencës (konsulente), ligjërisht të pranueshme, të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimit të kërkuar. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet (si: broshura, përshkrimi i minimumi tri detyrave të ngjashme të ndërmarra nga konsulenti, eksperiencë në kushte të ngjashme, kualifikimet e përgjithshme dhe përvojën dhe numrin e stafit kyç të përshtatshëm për këtë

detyrë etj.) dhe dokumentet ligjore, si vijojnë: 1. Ekstrakt historik origjinal të regjistrimit të biznesit (lëshuar nga QKR-ja) dhe numrin përkatës të identifikimit të biznesit (NIPT); 2. Dokument origjinal të lëshuar nga autoriteti përkatës tatimor që të vërtetojë se biznesi nuk ka asnjë detyrim ndaj autoriteteve tatimore shqiptare dhe ka paguar të gjitha sigurimet shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit shqiptar.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një *joint venture* apo në formën e nënkontraktimit, për të rritur kualifikimet e tyre.

Kriteret për shortlistimin janë:

Kriteret e shortlistimit	Pikët
Eksperienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit	20 pikë
Numri i kontratave që kanë lidhje me shërbimin, të përfunduara gjatë tri viteve të fundit	20 pikë
Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimet e stafit kryesor	20 pikë
Eksperienca specifike në fushën e shërbimit dhe kualifikimet e stafit kryesor	40 pikë
TOTALI	**100 pikë**

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA-së, dhe grante nga huamarrësit e Bankës Botërore* (Udhëzuesi i konsulencës, version i janarit të 2011-ës).

Konsulenti do të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është: "Përzgjedhje sipas kualifikimit të konsuletëve (CQ)", e përcaktuar në udhëzuesit e Bankës Botërore, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore për përzgjedhjen e punësimin e konsulentëve (e janarit të 2011-ës).

Për më shumë informacion, mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00–16:00 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail)* deri më **28 nëntor 2018**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kati 1

Rruga e Kavajës, nr. 53, Tiranë, Albania

Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2018